



Republika e Maqedonisë së Veriut – Institucioni Nacional Qendra për kulturë „Vëllezërit Miladinovci“ – Strugë

Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për punonjësit në sektorin publik dhe nenit 22 paragrafi (1) rreshti (1), paragrafi (4) të Ligjit për marrëdhëniet e punës, Qendra për kulturë "Vëllezërit Miladinovci" - Strugë, publikon

SHPALLJE PUBLIKE Nr. 2/2021

Për punësimin e punëtorit me kohë të pacaktuar për punë në vijim:

Numri rendor, shifër dhe titulli i vendit të punës	1. Pastrues , KUL 0401B03001
Numri i punonjësve	1 (një)
Kushtet e përgjithshme të cilat duhet t'i plotësojnë kandidatët:	Të jetë shtetas i-e Republikës së Maqedonisë së Veriut; Njohje aktive të gjuhës maqedonase, Të jetë i moshës madhore, Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore,
Kushte të posaçme	Shkalla e arsimimit – më së paku të ketë shkollë fillore Eksperience në pune: pa eksperiencë në punë
Programi i orarit të punës, fillimi dhe mbarimi i orëve ditore dhe javore	Orari i punës gjatë javës është – maksimumi 40 orë në javë, orari i punës me fillim; e hënë – e premte nga ora 8 deri 16.
Paga neto (bazë) e rrogës	17404 denarë
Në pajtim me planin vjetor për punësim në institucion për vitin 2021, është parapar punësimi për Shqiptar – e.	

Afati i fundit për dorëzimin e fletëparaqitjes për punësim: 5 (pesë) ditë pune nga dita botimit në gazetën ditore.

Fletëparaqitjen (aplikimin) për punësim me dokumentet e obliguara për plotësimin e kushteve të punës (në formë letre), kandidatët duhet të paraqesin në arkivin e institucionit ose me postë në adresën e mëposhtme:

Qendra për kulturë „Vëllezërit Miladinovci“ – Strugë

rr. 15- ti Korpus pn 6330 Strugë

(Me shënim për shpallje publike nr. 2/2021)

Mënyra e zbatimit të procedurës së përzgjedhjes do të zbatohet në përputhje me Ligjin për sektorin publik, Ligjin për kulturë dhe në pajtim me rregulloret e përgjithshme të punës, që janë në fuqi në shtet, përkatësisht, përzgjedhja administrave për kontrollimin e besueshmërisë së të dhënave dhe provave të paraqitura nga kandidatët në shpalljen publike ; intervistë me kandidatë që kanë kaluar me sukses procedurën e bazuar në prova.

Aplikimi për punësim për vendin e punës përmban :

- Të dhëna për kandidatin (emri dhe mbiemri, numri amëz i qytetarit, data dhe vendi i lindjes, adresa dhe vendi i banimit, adresa e postës elektronike të kandidatit, telefoni i kontaktit, përkatësia e bashkësisë (kombësisë)), si dhe një letër e shkurtër motivuese;
- biografi e shkurtër;
- Deklaratë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme për vendin e punës duke theksuar PO / JO për secilin kusht veç e veç;
- Deklaratë për përmbushjen e kushteve të veçanta për vendin e punës duke theksuar PO / JO për secilin kusht veç e veç.

Kandidatët për vendet e punës duhet të kenë bashkë me fletëparaqitjen për shpalljen e publikuar dhe ti dorëzojnë në formë origjinale ose kopje te noterizuar këto dokumente:

1. Dëshmi për nënshtetësinë e Republikës së Maqedonisë Veriore
2. Vërtetim i gjendjes së përgjithshme shëndetësore / certifikatë mjekësore
3. Vërtetim / diplomë për nivelin e përfunduar të arsimit
4. Deklaratë e vetënëshkruar nga kandidati për njohje të gjuhës maqedonase

Kandidatët duhet të paraqesin të dhëna precize, të vlefshme dhe të sakta në formularin e aplikimit dhe dokumentet në formë origjinale ose kopje të noterizuar të bashkangjitura me aplikimin për shpallje Nr. 2/2021.

Republika e Maqedonisë së Veriut – Institucioni Nacional Qendra për kulturë „Vëllezërit Miladinovci“ – Strugë